



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**  
**DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL**

Nr. 9849/prot.

Korçë, më 25.10.2024

Lënda: Kthim përgjigje

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**KORÇË**

Në përgjigje të shkresës suajës protokolluar pranë Bashkisë Korçë në datë 23.10.2024 me Nr.Prot 9849, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Bashkia Korçë çdo vit nëpërmjet Drejtorisë së Kujdesit Social prej vitesh zbaton një sërë projektesh dhe aktivitete të ndryshme me qëllim informimin, sensibilizimin, ndërgjegjësimin e komunitetit.

Projekti “**Ndërgjegjësimi i Komunitetit nëpërmjet Aktiviteteve Sensibilizuese në Luftën Kundër Dhunës në Familje**”, ka si qëllim sensibilizimin e të gjithë komunitetit pa dallim feje, moshe, race, gjinie në mënyrë që informimi të bëhet për të gjithë , të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe informimi të jetë sa më i lartë.

Një aspekt shumë i rëndësishëm në luftimin e dhunës në familje është sensibilizimi ndaj fenomenit dhe aspekteve negative të tij.

Nga statistikat rezulton që komuniteti, kryesisht gra dhe vajza, ndonëse të dhunuara, nuk raportojnë për dhunën e ushtruar.

Ndërgjegjësimi dhe informimi nëpër shkolla si dhe takime informuese me gra dhe vajza është mjaft i rëndësishëm në mënyrë që të rritet denoncimi ndaj krimit të dhunës në familje në këto zona.

Ky fond u planifikua për aktivitete sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje për tu realizuar dhe për tu vënë në zbatim në muajin nëntor në 16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore.

Ky fond me propozim së Drejtorisë së Kujdesit Social ju kalua si një mbështetje financiare, me vendim Këshilli Bashkiak, datë 26/09/2024 Nr.126, shtetases M.T e cila në datën 31/08/2024 u dogj me benzinë nga bashkëshorti i saj duke i shkaktuar djegie të shkallës së tretë në trup. Kjo ndihmë financiare i kaloi shtetases M.T dhe dy fëmijve të saj të mitur pasi nga plagët e marra është në pamundësi për të punuar dhe për të siguruar të ardhura për veten dhe fëmijët e saj.

Projekti “Ndërgjegjësimi i Komunitetit nëpërmjet Aktiviteteve Sensibilizuese në Luftën Kundër Dhunës në Familje” do të realizohet përgjatë muajit Nëntor-Dhjetor nëpërmjet aktiviteteve informuese, sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere si në qytet dhe në njësi administrative.

Gjithashtu projekti “**Ndërgjegjësimi i institucioneve publike dhe private për Barazinë Gjinore**” do të zbatohet për herë të parë si projekt nga Drejtoria e Kujdesit Social ku ka si qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e institucioneve për trajtim dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe ndihmë në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës.

Një aspekt shumë i rëndësishëm është promovimi i të drejtës për barazi të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, si parakusht themelor për demokracinë dhe shoqërinë demokratike.

Nga feedback- u i marrë në takimet e “Ndërgjegjësimit të Komunitetit nëpërmjet Aktiviteteve Sensibilizuese në Luftën Kundër Dhunës me Bazë Gjinore” rezulton se është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit gjinor në zonat urbane dhe rurale.

Në fokus të këtyre takimeve do të jenë komuniteti, institucione si edhe ndermarje të ndryshme si fasoneri/rrobaqepësi, fabrikat e këpucëve.

Ky projekt do vihet në zbatim nga muaji nëntor dhe do të shtrihet përgjatë muajve në vijim.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**DREJTORE**

**MARIANA JORGJI**